


## Mars 2017

### Tema të nxehta

#### **Roland Liemberger Deklaron: “Shoqëritë Ujësjiellës Kanalizime duhet të mbajnë një Qëndrim “Ne mundemi” për Menaxhimin e Humbjeve të Ujit.”**



Të parashikosh të ardhmen është një biznes i rrezikshëm. Nga risitë teknologjike tek ndryshimet klimatike, dhe gjithçka midis, bota rreth nesh duket të jetë

më pak e parashikueshme, më pak e sigurtë dhe duke ndryshuar në një shkallë të padëgjuar. Kjo është po aq e vërtetë në sektorin e ujit si kudo tjetër, me përjashtim kur bëhet fjalë për menaxhimin e humbjeve të ujit. Konceptet dhe aparaturat e zhvilluara gjatë 20 viteve të fundit mund të zgjidhin problemin botëror të ujit pa të ardhura. Aq shumë progres është bërë sa që sot nuk ka mbetur asnjë përparim domethënës, asnjë Lajm i Madh për t’u njoftuar, apo metoda krejtësisht të reja që do të mund të ndryshonin situatën në mënyrë drastike. Po, ka gjithmonë ide dhe pajisje të reja dhe ekzotike, disa mund edhe të funksionojnë, por shumë nga këto “lodra” janë thjesht shumë të shtrenjta për shoqëritë ujësjiellës kanalizime mesatare, dhe shumica nuk janë të nevojshme për të zvogëluar humbjet e ujit. Pyetja e vërtetë është përse, kur ne i kemi përgjigjet, nivelet e rrjedhjeve janë ende kaq të larta në pjesën më të madhe të botës? Përse shumica e qyteteve të botës ende kanë humbje që tejkalojnë nivelet ekonomike? A duhet kjo të mos konsiderohet “e papërgjegjshme” në një epokë të ndryshimit klimatik? [lexo më](#)



### Rreth SHUKALB

Shoqata Ujësjiellës Kanalizime e Shqipërisë (SHUKALB), e themeluar në vitin 2000, është një Shoqatë profesionale, jofitimprurëse e profesionistëve në sektorin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve, e cila synon të përmirësojë menaxhimin e Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve në Shqipëri, për ta bërë atë më eficient, të qëndrueshëm dhe efektiv në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi në Shqipëri.

### Kurset e Ardhshme të Trajnimit!

[Cilësia e Ujit në Sistemin e Shpërndarjes](#) - 16-17 Mars

[Udhëzues për Anëtarët e Këshillit të Administrimit të Shoqërisë Ujësjiellës](#)

## Lajme nga Anëtarët tanë

### Shkodër ja ku po vij: Vendimi i Karrierës së një Inxhinierje të Re



Vitin e kaluar tek "Burimi", SHUKALB publikoi një seri artikujsh që përfshinin intervista me punonjës nga shoqëri ujësjellës kanalizimeve të ndryshme në Shqipëri. Këto intervista kishin për qëllim të sillnin në fokus asetin më të vlefshëm në sektorin e ujit, burrat dhe gratë që sigurojnë

shpërndarjen e shërbimeve të ujit të pijshëm dhe kanalizimeve për popullin e Shqipërisë. Këtë muaj, BURIMI ndan me ju një intervistë me një inxhinier të re, e cila gjatë muajit shkurt, mori pjesë në Kursin e Trajnimit të SHUKALB "Menaxhimi i Humbjeve të Ujit". Emri i saj është Mbaresa Ferracaku, Përgjegjëse e Degës Teknike të Shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Shkodër. Mbaresa, e cila është 24 vjeç, ka lindur në qytetin e Lushnjës, dhe aktualisht jeton në Tiranë. Çdo ditë, ajo udhëton nga Tirana për në Shkodër, dhe anasjelltas, por distanca nuk e mërzit atë. Ajo thotë: "Unë e dua profesionin tim dhe dua të investoj për të." [lexo më shumë](#)

## Programi i Trajnimit të SHUKALB, 2017

### Kurset e Trajnimit të Dhëna në Shkurt



Gjatë muajit shkurt, SHUKALB dha me sukses dy kurse e para të trajnimit për këtë vit. Kursi i parë i trajnimit "Menaxhimi i Humbjeve të Ujit -I" u dha më

20-21 shkurt 2017, nga lektorët Astrit Menalla dhe Ervin Bucpapaj, dhe u ndoq nga pjesëmarrës nga shoqëritë ujësjellës kanalizime Fier, Berat-Kuçovë, Shkodër, Lezhë,

## Kanalizime - 30-31 Mars

### Eventet e Ardhsme!

Dita Botërore e Ujit - 22 Mars

### Bashkohuni me Ne!



Na tregoni se cfarë mendoni!



Malësi e Madhe dhe Vlorë. Ky kurs trajnimi mbuloi tema të tilla si Menaxhimi i Humbjeve të Ujit në Shqipëri, Të Kuptojmë Humbjet Teknike, Monitorimi i Performancës së Menaxhimit të Ujit Pa të Ardhura, Menaxhimi i Presionit dhe Zvogëlimi i Humbjeve të Ujit, Kryerja e Auditit të Ujit, Të Kuptojmë Humbjet Administrative dhe Të Kuptojmë Zonat e Matura të Shërbimit (ZMSH). Pjesëmarrësit patën mundësinë të praktikonin një ushtrim mbi të dhënat e bilancit të ujit për llogaritjen e auditimit të ujit, ku ata përdorën të dhëna nga shoqëritë e tyre. [lexo më shumë](#)

## Kurs Trajnimi në Fokus



Më 30-31 mars, SHUKALB do të japë kursin e trajnimit “Udhëzues për Anëtarët e Këshillit të Administrimit të Shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime”. Ky trajnim

shërben për të gjithë individët të cilët janë emëruar si anëtar në Këshillin Administrativ të një shoqërie ujësjetllës kanalizime në Shqipëri. Kursi i trajnimit adreson çështje administrative dhe operacionale të Shoqërive Ujësjetllës Kanalizime, ligje dhe rregullore që ndikojnë në menaxhimin dhe operimin e shoqërisë, rolin e rregullatorit ekonomik në licencimin dhe miratimin e tarifave, instrumentat dhe metodologjitë për monitorimin e performancës së shoqërisë dhe planin e biznesit për të forcuar menaxhimin dhe mbikëqyrjen e shoqërisë. [lexo më shumë](#)

---

## Çfarë ka të Re në SHUKALB!

### Po Bëhemi Gati për të Festuar Ditën Botërore të Ujit!



Festimi i Ditës Botërore të Ujit (DBU) është bërë një traditë për SHUKALB dhe shoqëritë ujësjetllës kanalizime anëtare të tij, si një mundësi e veçantë për të tërhequr vëmendjen

dhe për të krijuar mundësinë për të nxitur qeverinë, shoqërinë civile dhe individët të ndër marrin iniciativa të tilla ndërgjegjësimi. Dita Botërore e Ujit është një Program i Kombeve të Bashkuara, që festohet çdo vit më 22 mars, ka

për qëllim ndërgjegjësimin mbi rëndësinë e ujërave të ëmbla dhe advokimin për menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve të ujërave të ëmbla. Çdo vit, Dita Botërore e Ujit nxjerr në pah një aspekt të veçantë të ujit, dhe tema e zgjedhur nga OKB-ja për këtë vit është “Uji i Ndotur”. [lexo më shumë](#)

## **Bordet e Drejtorëve të SHUKALB-SHUKOS Takohen për të Diskutuar Programe të Përbashkëta**



Më 3 shkurt, Bordet e Drejtorëve të SHUKALB dhe të SHUKOS u takuan në Tiranë në një takim të përbashkët për të diskutuar mbi performancën e Konferencës dhe Ekspozitës së

Përbashkët të vitit të kaluar, Programin e Përbashkët të Trajnimeve, si dhe planet për Konferencën e Përbashkët Ballkanike 2017 që do të mbahet në Prishtinë në muajin nëntor. Përmes një prezantimi të bërë nga stafi i të dy shoqatave, të dy Bordet e Drejtorëve u informuan mbi nivelin e pjesëmarrjes në Konferencën dhe Ekspozitën e Përbashkët Ballkanike 2016 e analizuar sipas kategorive të pjesëmarrjes (shoqëritë ujësjellës kanalizime, kompanitë private, institucionet publike, OJQ-të, profesionistët e rinj të ujit , etj); pjesëmarrja sipas vendeve dhe sipas gjinisë. [lexo më shumë](#)

## **Shoqata Ujësjellës Kanalizime e Hungarisë viziton SHUKALB**



Më 6 shkurt, SHUKALB u takua me përfaqësues të Shoqatës Ujësjellës Kanalizime të Hungarisë (MaVíz), për të diskutuar mbi fusha të mundshme bashkëpunimi midis dy shoqatave.

Qëllimi i takimit ishte vendosja e marrëdhënieve më të ngushta midis SHUKALB dhe MaVíz, dhe për të përgatitur përmbajtjen e një Memorandumi Mirëkuptimi. Diskutimi u fokusua në mundësitë e bashkëpunimit për trajnime dhe edukim midis dy Shoqatave dhe vendosjen e kontakteve midis Profesionistëve të Rinj të Ujit të Shqipërisë dhe Hungarisë. [lexo më shumë](#)

**Shoqata Ujësjetllës Kanalizime e Shqipërisë,**

Rruga "Pjeter Bogdani", 39/1, k5, 3, Njësia Bashkiake Nr. 5, Kodi Postar 1019, Tirane, Shqiperi

Tel/Fax: (+355/4) 2245 101, Mob: (+355) 69 60 12 782

**E-mail:** [info@shukalb.al](mailto:info@shukalb.al), **Web:** [www.shukalb.al](http://www.shukalb.al)